

URDHËR
Nr. 809, datë 25.5.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË ZYRTARËVE TË ADMINISTRATËS
TATIMORE, TË CILËT I NËNSHTROHEN KUFIZIMEVE TË NENIT 32, TË LIGJIT
NR. 9367, DATË 7.4.2005 “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE
NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 42 pika 2 dhe nenit 32 germa “c”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, urdhrit nr. 126, datë 2.8.2016, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjësve të administratës tatimore qendrore”, urdhrit nr. 19, datë 22.2.2017, të Ministrit të Financave “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore” dhe Rregullores së Brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

URDHËROJ:

Kategoria e zyrtarëve të administratës tatimore, që do të përfshihen në kufizimet e parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, të cilët nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që shlyejnë detyrimet tatimore ose ushtrojnë veprimtari sipas fushës apo juridiksionit territorial, të kategorizuar sipas funksionit do të jenë:

- 1. Drejtori i Përgjithshëm**
- 2. Zëvendës drejtorët e përgjithshëm**
- 3. Kabineti**
 - Drejtor Kabineti
 - Këshilltar
- 4. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (DIBA)**
 - Drejtor drejtorie
 - Inspektorët
- 5. Drejtoria e Auditit të Brendshëm**
 - Drejtor drejtorie
 - Inspektorët
- 6. Drejtoria e Hetimit Tatimor**
 - Drejtor drejtorie
- 7. Sektori i Hetimit Tatimor**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 8. Sektori i Analizës**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 9. Sektori i Zbatimit (Task Forcë)**
 - Përgjegjës sektori/zyre
 - Inspektorët
- 10. Sektori Parandalimit të Pastrimit të Parave**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 11. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut**
 - Drejtor drejtorie

12. Sektori i Përmeshjes

- Përgjegjës sektori
- Inspektorët

13. Sektori i Analizës së Riskut

- Përgjegjës sektori
- Inspektorët

14. Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori

15. Drejtoria e Mbledhjes me Forcë

- Drejtor drejtorie

16. Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve

- Inspektorët

17. Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara

- Përgjegjës sektori
- Inspektorët

18. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori

19. Drejtoria e Kontrollit Tatimor

- Drejtor drejtorie
- Sektori i Transferimit të Çmimit

20. Përgjegjës Sektori

- Inspektorët

21. Sektori i Kontrollit Tatimor

- Përgjegjës sektori
- Inspektorët

22. Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave

- Përgjegjës Sektori
- Inspektorët

23. Drejtoria Rimbursimit të TVSH-së

- Drejtor drejtorie
- Inspektorët

24. Drejtoria Ligjore dhe Teknike

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori

25. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori

26. Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve

- Drejtor drejtorie
- Inspektorët

27. Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori

28. Drejtoria e Burimeve Njerëzore

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori

29. Qendra e Pagesave

- Drejtor Qendre

30. Qendra e Thirrjeve

- Drejtor Qendre
- Përgjegjës sektori

31. Drejtoritë rajonale

- Drejtor rajonal
- Drejtor Drejtorie/Mbledhjes së Borxhit/Kontrollit Tatimor/Analizës dhe IT/ Hetimit Tatimor/Shërbimit të Tatimpaguesve /Mbledhjes me Forcë.

- Përgjegjës sektori/zyre
- Inspektorët.

32. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj

- Drejtor drejtorie
- Drejtor Drejtorie/Mbledhjes së Borxhit/ Kontrollit Tatimor/Analizës dhe IT/Shërbimit të Tatimpaguesve.

- Përgjegjës sektori
- Inspektorët.

Urdhri nr. 1008, datë 24.6.2014 i Inspektorit të Përgjithshëm, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj